



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranimi / Pranimja Nr. 04-05-2026			
Nr. i Aktit / Act No.	Nomenklatura / Nomenclature	Titulli / Title	Vlera / Value
07-110/05-		490	



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, neni 40, paragrafi 40.2, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008), neni 2 dhe 4 i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, neni 35, paragrafi 35.2, pika b të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 30.04.2026 miraton këtë:

V E N D I M

për kthimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për kthimin e mjeteve të pa shpenzuara të Grantit të Performancës Komunale në kuadër të Marrëveshjeve tre palëshe Nr.102/2 2023 dhe 103/2023. me nenin 8.2 në llogarinë e DEMOS-it, shuma 105,909.47 €.

Fondi burimor 10, kategoria ekonomike, "Investime kapitale, shuma 65,382 € nga Programi, Buxhet e Financa - 17533, nga projekti:

- Ndërtimi i qendrës kulturore Pozheran, kodi i projektit 57165, shuma prej 15,382 €.

Programi, Shërbimet sociale rezidenciale - 75661 nga projekti:

- Ndërtimi i shtëpisë së komunitetit për përsone me aftësi të kufizuara kodi i projektit 52886 shuma 50,000.00€

Fondi burimor 21, kategoria ekonomike "Investime kapitale" shuma 40.527,47 € nga programi "Buxhet e Financa" - 17533 nga projektet

- Ndërtimi i palestrës sportive të shkolla Bafti Haxhiu - kodi i projektit 56365 shuma prej 10,000.00
- Ndërtimi i parkut të qytetit në Viti - kodi i projektit 56367 shuma prej 10,000 €
- Ndërtimi i fabrikës së ujit të pijes dhe kolektori i ujrave të zeza - kodi i projektit 56370 shuma prej 10.000€.
- Ndërtimi i "qyteti inteligjent -menqur"(Ndërtimi i pritoreve,tabelave informuese, ulëse betoni , kontenjer nëntoksor , instalimi i kamerave etj) - kodi i projektit 56371 shuma 10,000 €
- Ndërtimi i rrugës me zhavor Stubëll - Stançiq - kodi i projektit 52787 shuma prej 527.47 €.

Neni 2

Pas lejimit të ridestinitimit të mjeteve nga neni 1 i këtij vendimi, nga Ministria për Financa, Punë dhe Transfere, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim do të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr.08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr.08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), neni 5, paragrafi 1, si dhe neni 8, lidhur me nenin 9, paragrafi 1, të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare, në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyra së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Financa;
3. Shërbimit të Kuvendit;
4. MAPL-së; dhe
5. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi

